



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Prilbjen/Prilato Received/Delivery	07.11.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Org./Unit	Nr Prot B/ Prot Prot No	Shtoja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHCK	6766	2022	1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.829/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga : Arben Mehmeti- kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë -anëtarë, me Rushit Kajtazi- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.829/2022, të datës 27.09.2022, së ankueses

kundër organit të punësimit Komuna e Vitisë, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, neni 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 07.11.2022, mori këtë.

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.829/2022, e datës 27.09.2022, e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi, Vendimi i datës 09.09.2022, me numër protokollit 02-070/01-36687, i Kryetarit të Komunës së Vitisë.

Arsyetim

Ankuesja e punësuar në pozitë, Zyrtare për barazi gjinore dhe mbrojtje nga diskriminimi në Komunën e Vitisë, me datë 27.09.2022, ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5696/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore lidhur me kompensimin si pjesëmarrëse në takimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, në Komunën e Vitisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 30.09.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Vitisë ndërsa Komuna e Vitisë , me datë 31.09.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë në Këshill .

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën A.nr 829/2022 të datës 27.09.2022 me numër protokollit 5696/2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; kërkesë e datës 24.08.2022 me numër protokollit 02-070/01-36687; Vendimi i datës 08.02.2022, me numër protokollit 01-410/03-71 për Formimin e Këshillit Komunal për Siguri dhe Bashkësi; Vendimi i datës 09.09.2022, me numër protokollit 02-070/01-36687; Lista e anëtarëve të KKSB- së, e datës 14.03.2018; Lista e anëtarëve të KKSB- së, e datës 14.09.2021; Lista e anëtarëve të KKSB- së, e datës 20.08.2020; Lista e anëtarëve të KKSB- së, e datës 15.06.2020; Lista e anëtarëve të KKSB- së, e datës 12.12.2019; Lista e anëtarëve të KKSB- së, e datës 08.07.2019; Lista e anëtarëve të KKSB- së, e datës 22.05.2019; Lista e anëtarëve të KKSB- së, e datës 07.03.2019; Lista e anëtarëve të KKSB- së, e datës 19.01.2018; Lista e anëtarëve të KKSB- së, e datës 18.10.2018; Lista e anëtarëve të KKSB- së, e datës 10.07.2018; Lista e anëtarëve të KKSB- së, e datës 07.06.2018; Lista e anëtarëve të KKSB- së, e datës 03.03.2022; Lista e anëtarëve të KKSB- së, e datës 16.12.2018; Lista e anëtarëve të KKSB- së, e datës 27.06.2022, kërkesë për përgjigje në ankesë datë 30/09/2022 dhe Përgjigje në ankesë përmes e-mailit zyrtar të datës 31.10.2022 me numër protokollit 6570/2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses [redacted] është e pa bazuar sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses, e cila nga organi i punësimit Komuna e Vitisë, ka kërkuar që ti bëhet kompensimi i mëditjeve për takimet e mbajtura në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, ka konstatuar se bazuar në shkresat e lëndës si dhe duke marrë për bazë legjislacionin aktual që rregullon këtë çështje, pretendimi ankimor i ankueses është i pa bazuar nga arsyet që do të specifikohen më poshtë.

Bazuar në shkresat e lëndës është konstatuar se ankuesja [redacted] ka qenë dhe është anëtare e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Vitisë që vërtetohet përmes listës së pjesëmarrjes së anëtarëve të KKSB- së, në takimet prej datës 14.03.2018 si dhe takimet tjera që janë mbajtur deri më datë 27.06.2022 , bazuar në pozitën që mbanë sipas aktemrimit të fundit bazuar në udhëzimin administrativ të MPB-së Nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL të datës 22/08/2012 e njëjta ex-officio duhet të jetë anëtare e këtij këshilli bazuar në nenin 4 paragrafi 1.6 të këtij udhëzimi, ankuesja ka marr pjesë si anëtare në cilësinë e Zyrtares për Barazi Gjinore, në Komunën e Vitisë gjatë orarit të punës, ndërsa kolegji me rastin e shqyrtimit të kësaj lënde ka konstatuar se bazuar në shkresat e lëndës që kanë ofruar palët në këtë procedurë nuk ka asnjë dëshmi që ankuesja ka kryer punë jashtë orarit të punës e cila mund të konfirmohet me dokumentacion përkatës dhe mbi këtë bazë pretendimi i ankueses për kompensim me rastin e pjesëmarrjes në këto takime është i pabazuar.

Ndërsa duke elaboruar edhe më në hollësi vendimin e datës 09.09.2022, me numër protokolli 02-070/01-36687, të nxjerr nga Kryetari i Komunës së Vitisë, kolegji konstaton se ankuesja punën e ka kryer në orarin e rregullt të punës prej orës 08:00 deri 16:00, dhe me qenë se pjesëmarrja në këto takime të KKS-së nga ankuesja është kryer brenda orarit të rregullt të punës, kolegji konstaton se me qenë se nuk kemi të bëjmë me punë jashtë orarit të rregullt, andaj pretendimi ankimor i ankueses është i pabazuar sepse kjo çështje është e rregulluar edhe me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, si dhe Rregullorja NR. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë.

Kolegji i këshillit bazuar në at që u konstatue si më lartë, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankueses është i pabazuar, sepse bazuar në dispozitat e nenit 80, të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, përcaktohet se; *“Nëse një punonjës, shërbyes civil ose zyrtar i një autoriteti publik ose organizatë buxhetore, sipas një akti të Qeverisë, kërkohet që të shërbejë në një komision, bord ose organ apo autoritet tjetër publik, ky punonjës, shërbyes civil ose zyrtar nuk ka të drejtë të pranojë, dhe nuk do të pranojë, kurrfarë kompensimi shtesë për këtë shërbim. Shërbimi konsiderohet pjesë e detyrave të obligueshme të postit të cilin e mban punonjësi, shërbyesi civil ose zyrtari i sipër cekur”,* prandaj në këtë kuptim me qenë se kemi të bëjmë me pjesëmarrjen e ankueses në një grup/komision/këshill bazuar në një akt nënligjor të MPB-së-MAPL-së, të njëjtës bazuar në dispozitat e Ligjit NR. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë të potencuara si më lartë nuk i takon kompensimi me rastin e pjesëmarrjes së të njëjtës në këto takime, rrjedhimisht pretendimi i ankueses mbi këtë bazë është i pajustificuar dhe paargumentuar me fakte konkrete.

Ndërlidhur me Vendimin e datës 09.09.2022, me numër protokolli 02-070/01-36687, me të cilin Vendim Kryetari i Komunës së Vitisë, ka refuzuar kërkesën e ankueses me arsyetimin, së në bazë të nenit 80, të Ligjit NR. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nuk i takon kompensim nëpunësit civil, dispozitë të cilën e cituam më lartë, kolegji konstaton se këshilla juridike në përmbajtje të aktit administrativë të kontestuar është dhënë gabimisht dhe se e njëjta është në kundërshtim me nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: *“3.Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHCK për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji”,* ndërsa sipas nenit 127 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 05/L -031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative përcaktohet se: *“3.Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni, është tre (3) muaj”,* dhe në këtë kuptim me qenë se këshilla juridike nuk ka pasur ndonjë ndikim sa i përket realizimit të së drejtës së ankueses nga se e njëjta pavarësisht se i ishte dhënë gabimisht këshilla juridike, ajo ishte ankuar drejtpërdrejtë në KPMSHCK dhe mbi këtë bazë me qenë se ankuesja ka shfrytëzuar të drejtën e ankesës, kolegji konstaton se me qenë se nuk i është cenuar mundësia e ankesës palës, i njëjti vendim përkundër që gabimisht e ka këshillën juridike nuk është shfuqizuar për faktin se sipas fuqisë ligjore ndonjë elementë në kuadër të një akti administrativë që nuk ka mbështetje ligjore është pa efekt juridik dhe në këtë kuptim Vendimi i datës 09.09.2022, me numër protokolli 02-070/01-36687 i kryetarit të komunës së Vitisë me përjashtim të këshillës juridike që i kishte dhënë gabimisht ankueses në përmbajtje ishte i bazuar në legjislacionin në fuqi dhe mbi këtë bazë edhe është lënë në fuqi si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin

Civil të Kosovës, si dhe nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda.A.nr.829/2022,datë 07/11/2022.

Rushit KAJTAZI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional,



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, [REDACTED]
- Kryetarit të Komunës së Vitisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Vitisë , dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.

